



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.477/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj, dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal Bedri Imishti, nga rradhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet si e pasafatshme** ankesa e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Bedri Imishti, nga rradhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, me shenjen ZL.Anr.477/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP, më datë 23.10.2017, ka pranuar një ankesë nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Bedri Imishti, nga rradhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, me të cilën ka pretenduar se, dyshon që ka pasur parregullsi në këto Qendra të Votimit: Në Shkollën Filllore “Ilaz Thaqi” në Han të Elezit, në Qendrat e Votimit 3301d/01, 3301d/02, 3301d/03, 3301d/04 dhe 3301d/05, në fshatin Goranc në Qendrat e Votimit 3303d/1 3303d/2 si dhe në fshatin Selishtë në Qendrat e Votimit 3304/1 dhe 3304/2, me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më tej ka theksuar se e ka konfirmimin e votës nga një votues se e ka votuar atë, ndërsa vota nuk figuron në vendvotim.

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme.**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 23.06.2017 në ora 20:35 minuta. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet

ankimore të parashtruar nga ankuesi në ankesë ZL.Anr.477/2017 të datës 23.10.2017, ndërlidhet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP me datë 23.10.2017, në ora 20:35 minuta, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.477/2017 më datën 24.10.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
Zyhdi Haziri



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.